

LEONARD DAUTI

**MBI TIPOLOGJINË E LIDHJEVE KOHEZIVE
NË GJUHËN SHQIPE**

Gjithmonë kur synojmë të grupojmë së bashku elemente të caktuara, e mbi bazën e këtyre grupeve të krijojmë klasat përkatëse, merr rëndësi të dorës së parë përcaktimi i qartë i kriterëve mbi të cilat do të bazohet një klasifikim i tillë. Vetë përzgjedhja e kriterëve kushtëzohet nga këndvështrimi teorik dhe metodologjia përkatëse e zbatuar për objektin tonë të studimit. Në fund të fundit, ky është një proces i bazuar në parashtrime të caktuara teorike dhe si i tillë është gjithmonë objekt kritike e ndryshimi në përputhje me zhvillimin e mendimit teorik, me këndvështrimet e reja teorike që përpunohen dhe afirmohen në rrjedhë të kohës.

Kësaj ligjësie i është nënshtruar edhe klasifikimi i mjeteve kohezive, përkatësisht i lidhjeve kohezive, që dalin si pjesë e organizimit të strukturës sipërfaqësore të tekstit.

Koncepti se teksti është një njësi semantike, një njësi kuptimore dhe jo formale (Halliday & Hasan, 1976:2), ka shërbyer si premisë për klasifikimin që u janë bërë lidhjeve kohezive. Sipas dy autorëve të cituar më sipër, kohezioni është një koncept semantik, i cili iu referohet lidhjeve kuptimore që ekzistojnë brenda një teksti të caktuar. Kohezioni shfaqet atëherë kur interpretimi i një elementi të diskursit varet nga një element tjetër (Halliday & Hasan, 1976:4). Duke e shpjeguar gjuhën si një sistem të organizuar në tri nivele: 1) semantik; 2) leksiko-gramatikor; 3) fonologjik, ata pohojnë që kohezioni shprehet përmes këtij organizimi të gjuhës (Poaty, 1976:5). Kjo nënkupton se ai pasqyron lidhjet që ekzistojnë midis elementeve gjuhësore si pjesë e ligjësive që organizojnë sistemin gjuhësor si sistem semantik. Duke e kërkuar motivimin e lidhjeve kohezive pikërisht te ligjësitë që veprojnë brenda sistemit gjuhësor, ata parashtrojnë klasifikimin e kohezionit në kohezion gramatikor dhe kohezion leksikor, që do të thotë se disa forma të kohezionit realizohen përmes gramatikës dhe disa të tjera përmes leksikut.

Duke dalluar koherencën si kriter të veçantë të tekstualitetit, De Beaugrande-i dhe Dressler-i e konceptuan kohezionin si lidhje mes elementeve gjuhësore të sipërfaqes së tekstit, ashtu siç i dëgjojmë dhe i

shohim. Kjo lidhje, sipas tyre, bazohet në ndërvaresitë dhe konvencionet gramatikore (1981:3-4). Edhe në këtë rast kohezioni shikohet si lidhje e njësive gjuhësore, e bazuar mbi ligjësitë që veprojnë për organizimin e sistemit gjuhësor.

Ndonëse qëndrimi i autorëve të dytë është kaq i ndryshëm prej të parëve, saqë hap një perspektivë të re për konceptimin dhe analizën e tekstit, duke qenë se dallon qartë organizimin sipërfaqësor dhe atë të botës së thellë të tekstit, të shprehur në ndarjen përkatëse *kohezion - koherencë*, prapëseprapë edhe ata nuk e shikojnë kohezionin jashtë veprimit të sistemit gjuhësor.

Përgjithësisht, ky trajtim i kohezionit, ndonëse jo në mënyrë të ngurtë, është ruajtur edhe në studime të autorëve të mëvonshëm. Ai është parë përgjithësisht si produkt i bazuar kryesisht në sistemin gjuhësor.

Një konceptim i tillë i kohezionit, për mendimin tonë, është më i ngushtë nga sa vërteton analiza e tekstit dhe nuk mund të shërbejë për një interpretim të saktë të krejt lidhjeve kohezive. Në këtë kumtesë do të parashtrojmë qasjen tonë sipas së cilës, *kohezioni është lidhje e njësive gjuhësore brenda një teksti të caktuar, që përftohet si prodhim i bashkëveprimit të dy faktorëve*:

i) i sistematicitetit të brendshëm gjuhësor, të krijuar mbi bazën e ligjësive që organizojnë nënsistemet gjuhësore, përkatësisht, fonologjik, morfologjik, sintaksor dhe leksikor;

ii) i përdorimit pragmatik të gjuhës, i cili u jep vlerë të veçantë njësive të caktuara gjuhësore në procesin e ligjërimit, duke krijuar raporte dhe marrëdhënie të posaçme midis tyre në një kontekst dhe situatë të caktuar.

Ndër lidhjet kohezive të bazuara në ligjësitë e brendshme të sistemit gjuhësor më të spikaturat janë lidhjet kohezive semantike. Si të tilla përcaktohen përgjithësisht ato lidhje që bazohen në marrëdhëniet semantike midis leksemave, të cilat ne i kemi të regjistruara në leksikun mendor si pjesë të kompetencës sonë gjuhësore (Schwarz-Friesel & Consten, 2014:78). Si të tilla pranohen lidhjet e bazuara në *hiponimi*, *hiperonimi*, *metonimi*, *sinonimi* dhe *antonimi*. Lidhja e proformave vetore (përemrat vetorë të vetës së tretë) me emrin përkatës nuk është pjesë e marrëdhënieve semantike midis leksemave, por një marrëdhënie që krijohet dhe ruhet si e tillë në procesin e ligjërimit, pra brenda një teksti të caktuar. Ajo është marrëdhënie semantike në kuptimin që elementi i dytë (proforma vetore) plotësohet semantikisht dhe mund të interpretohet si e tillë vetëm brenda tekstit. Kjo bazohet në veçorinë e kësaj kategorie leksiko-gramatikore për t'u plotësuar semantikisht përmes lidhjes referuese

me një element tjetër gjuhësor. Është fjala pikërisht për atë *konvencion gramatikor* që përmendëm në citimin e mësipërm të de Beaugrade-it dhe Dressler-it. Po i tillë shfaqet edhe rasti i foljes *bëj*, e cila merr kuptim të caktuar vetëm brenda një marrëdhënieje të krijuar me një folje tjetër brenda një teksti të caktuar, i përmrave *i tillë*, *i atillë*, *i këtillë*, si dhe i ndajfoljeve *kështu*, *ashtu* etj. Edhe lidhjet gramatikore që veprojnë përtej kufirit të fjalisë, e këtu kufizohemi vetëm te lidhjet e përshtatjes (Vater, 2001:10), përkatësisht lidhjet e mbaresave vetore dhe të treguesve kundranorë, kontribuojnë në kohezionin e bazuar në sistemin gjuhësor.

Gjithsesi, kemi edhe raste kur sintagma të caktuara emërore, ndonëse përputhen semantikisht, nuk shprehin ndonjë lidhje të brendshme të sistemit leksikor. Pra, jo çdo marrëdhënie semantike që krijohet midis elementeve gjuhësore në një tekst të dhënë është e motivueshme prej sistemit gjuhësor. Le të marrim dy shembujt e mëposhtëm:

(1) a. “*U mësova me shqiptarët e sotëm të pres ç’farë-do të bërash e të thënash buffone, po u rrëfej të vërtetën se nukë prisja të shoh një Bajo Topulli në rol të Cesarit. Posi i perëndishmi Julius, assassini i Fotit na urdhëron që “*debere homines consideratius jam loqui serum, ac pro legibus habere quae decate*”¹”. (Konica, Lajthm dhe marrësie!. Në: Kastrati, S. “Lufta e penave”, 2002:299)*

b. “*Po rruga hynte në një thellinë midis maleve dhe përsipër ngrihej Tomorri që sikur ia pengonte fluturimin. Mali i lartë, i lartë gjer në qiell, qe mbuluar me ujëvara mjegullash të varura në fasadat madhështore të maleve.*”
(Xhaferi, *vepra 2*, 2010:54)

Në (1a) *Bajo Topulli* dhe *assassini i Fotit* kanë të njëjtën domethënie, por nuk mund të flasim për një marrëdhënie semantike të motivueshme prej ligjësive që organizojnë leksikun tonë mendor mes këtyre dy grupeve emërore. Një zotërues shumë i mirë i shqipes, nuk mund të vendosë një lidhje semantike midis dy njësive të mësipërme, nëse nuk e ka pjesë së njohjes së tij të dhënë historike që Bajo Topulli ka qenë vrasësi i Fotit, mitropolitit të Korçës. Motivimi i lidhjes mes dy elementeve gjuhësore të

¹ Njerëzit më të ndershëm duhet të flasin me të, ndërsa për ligje do të kenë ato që thotë ai.

mësipërme realizohet përmes pjesëmarrjes së kontekstit historiko-kulturor në tekstin e caktuar. Përveç kësaj lidhjeje dallojmë edhe një sërë lidhjesh midis sintagmave të ndryshme, kryesisht emërore, të cilat veprojnë vetëm brenda një teksti të caktuar dhe jo jashtë tij. Në (1b) *Tomorri* dhe *mali i lartë* hyjnë në një lidhje midis tyre, e cila funksionon brenda këtij teksti të dhënë, pasi i referohen të njëjtut objekt jashtëgjuhësor. Por, në një tekst tjetër, *mali i lartë* mund t'i referohet një objekti tjetër, p. sh., Korabit ose Jezercës, gjë që dëshmon se kemi të bëjmë me një dukuri të përdorimit të gjuhës dhe jo të sistemit gjuhësor (Brinker, 1992:51).

Po e njëjta vërejtje vlen edhe për **përsëritjen** e të njëjtut element gjuhësor, të së njëjtës fjalë. Çdo leksemë, çdo fjalë, është e regjistruar vetëm një herë në kujtesën tonë. Pra, ajo ka vetëm një pozicion të caktuar në leksik. Ajo hyn në marrëdhënie sistematike me njësi të tjera, por jo me vetveten dhe si e tillë nuk është ligjësi e sistemit. Si dukuri ajo shfaqet në ligjërim, bile në disa forma të caktuara të ligjërit, siç është ligjërimi gojor, e përkatësisht dialogu. Prirja që vepron në hartimin e teksteve të shkruara është të shmanget përsëritja, përtej rasteve kur ajo është e motivuar për shkak të vlerave të caktuara stilistike. Arsyet e shfaqjes së përsëritjes në ligjërimin gojor janë të natyrës psikologjike dhe teknike:

- Kompetenca e pamjaftueshme gjuhësore;
- Mungesa e kohës për planifikimin e tekstit;
- Gjatë procesit verbal të të folurit struktura sipërfaqësore nuk regjistrohet në kujtesën e dhënësit dhe marrësit, kështu që humbet shpejt (de Beaugrande & Dressler, 1981:58), duke lënë vend shpesh edhe për përdorim të tepruar të përsëritjes;
- Përdorimi i qëllimshëm i motivuar stilistikisht.

Përsëritja nuk përfshin fjalë të veçanta. Në mjaft tekste përsëriten edhe modelet e organizimit të fjalëve (Salkie, 1995:7). Si dukuri e zakonshme e ligjërit të folur, kjo del edhe si mjet i spikatur stilistik për krijimin e dialogëve apo monologëve në tekstet letrare.

(2) “*Si ore, Mërtir, s’paska Krua të Rrahut? Si s’paska Man të Mëhillit? Si s’paska Krua të Pjetrit?*” (Kuteli, vepra 2, 1989:137).

Nëse për identifikimin e një lidhjeje kohezive ne marrim si pikënisje aksiomën se kohezioni shfaqet atëherë kur interpretimi i një elementi gjuhësor varet nga një element tjetër, atëherë përsëritja zor se do të mund të klasifikohet si pjesë e lidhjeve kohezive, pasi kemi të bëjmë me të njëjtin element që del në dy ose më shumë pozicione të ndryshme në tekst.

Nëse përsëritjen e pranojmë si mjet koheziv, sikurse pajtohen të gjithë studiuesit e kësaj fushe (Halliday & Hasan, 1976; de Beaugrande & Dressler, 1981; Salkie, 1999; Dibra & Varfi, 1999; Topalli, 2010; Rugova & Sejdiu-Rugova, 2015), atëherë duhet të pranojmë një kriter më përgjithësues për përcaktimin e lidhjeve kohezive.

Për përcaktimin e një kriteri të tillë do t'i largohemi këndvështrimit të gjuhës si sistem, duke u përqendruar në funksionimin e saj si mjet komunikimi, ku organizimi sipërfaqësor i tekstit nuk mund të shihet i shkëputur nga organizimi ideor e kompozicional i tij. Lidhja midis njësive gjuhësore është pasqyrë e lidhjeve mes ideve e koncepteve që përbëjnë brendinë e tekstit. Në bazë të këtij organizimi qëndron RIMARRJA. Rimarrja shfaqet në rrafshin e ndryshme (De Beaugrande & Dressler, 1981:57). Në rrafshin gramatikor, sipas Weinrich-ut (1972), rimerren kategoritë gramatikore. Në atë semantik, sipas Van Dijk-ut (1969, 1970), rimerren konceptet ose përbërës të tyre në mbështetje të koherencës së tekstit. Rimarrja ndeshet si në strukturën sipërfaqësore, ashtu edhe në atë të thellë të tekstit, e si e tillë edhe në organizimin e nyjave kohezive. Një element i caktuar gjuhësor – fjalë, sintagmë, e deri edhe fjali – rimerret brenda së njëjtës fjali, në një fjali tjetër, ose në një paragraf tjetër brenda të njëjtit tekst. Të gjitha nyjat kohezive organizohen mbi bazën e rimarrjes, ku elementi i dytë rimerr të parin.

Në trajtimet e gjuhësisë së tekstit prej autorëve tanë nuk është mbajtur i njëjti qëndrim në lidhje me rimarrjen. Në *Gjuhësi teksti* Dibra & Varfi (1999:43-44) e shohin rimarrjen si përsëritje të drejtpërdrejtë të elementeve gjuhësore, e cila bazohet mbi rishfaqjen e të njëjtit element. Ata dallojnë rimarrje të plotë (elementi që rimerret del me formë të njëjtë) dhe rimarrje të pjesshme (njësia gjuhësore kur rimerret i përket një kategorie të ndryshme leksiko-gramatikore). Duket se rimarrjen dy autorët e sipërpërmendur e barazojnë me rishfaqjen e të njëjtit element leksikor, çka përputhet me konceptin që qëndron pas termit **Rekurrenz** të përdorur prej de Beaugrande & Dressler (1981:51). Sipas përkufizimit të sipërpërmendur rimarrja trajtohet si një lloj i lidhjeve kohezive, sikurse lidhja që realizojnë proformat, elipsa etj. Këtij qëndrimi autorët Dibra dhe Varfi nuk i qëndrojnë besnikë, pasi në sythin mbi proformat bëjnë fjalë për tri lloje rimarrjesh: sintaksore, semantike, pragmatike (1999:55). Në këtë rast rimarrja nuk është rishfaqje e të njëjtit element, pasi elementi i parë rimerret përkatësisht me anë të një proforme përemërore (rimarrje sintaksore), me anë të një sinonimi ose hiperonimi (rimarrje semantike) dhe me anë të një perifraze (rimarrje pragmatike). Në këtë rast rimarrja

nuk shihet si një lloj i lidhjeve kohezive, por si parim i organizimit të këtyre lidhjeve. Në rastin e parë rimarrja shikohet vetëm në rrafshin sipërfaqësor, si rishfaqje e të njëjtit element gjuhësor, duke e barazuar atë me përsëritjen. Në rastin e dytë rimarrja shihet si element i strukturës së thellë të tekstit, pasi nuk kufizohet te njësia leksikore, por te rimarrja e të njëjtit koncept. Mund të themi se në rastin e parë kemi një shpërdorim të termit rimarrje. Më i saktë do të ishte përdorimi i termit **përsëritje**, pasi kemi përsëritje (rishfaqje) të së njëjtit element gjuhësor, pavarësisht prej referentit të jashtëm; elementet e përsëritura mund të karakterizohen nga bashkëreferenca, ose jo.

(3) *“I lava trupat e tyre dhe pastaj ia solla babait tënd. Do doja të kisha vdekur bashkë me ta, por trupi im ishte i fortë dhe megjithëse u plagos nuk u mposht nga dhimbja.* (Blushi, Shqipëria, 2011:80)

Fjala trup, që përsëritet në format përkatëse *trupat*, *trupi*, në thënien e parë ka një referent të ndryshëm prej atij të fjalës trup në thënien e dytë. *Trupat e tyre* ka një referent të ndryshëm prej referentit të *trupi im*. Në këtë rast nuk mund të flasim për rimarrje, por për përsëritje të së njëjtës njësi leksikore. Në bazë të përsëritjes në këtë rast qëndron rimarrja në fjalinë e dytë e konceptit ‘trup’, i cili aktualizohet përmes deiktikëve përkatës *e tyre*, *im*, duke krijuar një marrëdhënie kontrastuese midis fjalisë së dytë dhe të parës. Rimarrja, në këtë rast, ndodh vetëm në strukturën sipërfaqësore të tekstit dhe jo në atë të thellë të tij, pasi nuk rimerret i njëjti referent.

Një qëndrim më të drejtë, sipas nesh, mbahet në *Gjuhësi teksti* (2011) të autorit Tefë Topalli, i cili dallon **rikthimin** ose **përsëritjen** si një ndër mënyrat e realizimit të kohezionit. Termi **rikthim** i përgjigjet atij **Rekurrenz**. Në këtë vepër, përsëritja trajtohet si një mënyrë e organizimit të lidhjeve kohezive të tekstit. I njëjti qëndrim mbahet edhe në *Hyrje në gramatikën e tekstit të gjuhës shqipe* (Rugova & Sejdiu-Rugova, 2015), ku përsëritja klasifikohet si një ndër mjetet e realizimit të kohezionit.

Nisur nga sa parashtruam më lart ne mund të japim këtë klasifikim të mjeteve kohezive, duke u mbështetur në kriterin e motivimit të lidhjes kohezive:

1. kohezioni i brendshëm gjuhësor

A) **kohezioni fonologjik** – krijohet me anë të rimës, ritmit, simbolikës tingullore, intonacionit dhe strukturës së pauzave (Vater, 2001:31):

(4) *“Eja, trishtim,*

*O prehër i ëmbël që nuk më braktise kurrë,
O strehë e qetësisë sime,
O ëndërrime të mia,
O gji i shpresës sime!
Eja, trishtim,
Trishtim,
Eja.”
(Xhaferi, vepra 1, 2010:150)*

b) **kohezioni morfologjik** – shfaqet si lidhje mes një fjale të prejardhur dhe fjalëve prej të cilave ajo është përfutur (Vater, 2001:32):

(5) “Orfeu gjithashtu ishte përgatitur në fshehtësi të plotë. Përveç një ndryshimi që i kishte bërë lyrës, asgjë tjetër s’ishte marrë vesh. Ndryshimi kishte të bënte me numrin e telave: nga shtatë i kishte çuar në nëntë. ... Unë vetë mbase jam i shijes së vjetër, por mendoj se të gjithëve na është mësuar veshi me lyrën e moçme shtatëtelshe.” (Kadare, *E penguara*, 2009:92).

c) **kohezioni sintaksor** – përfshin tërësinë e lidhjeve të bazuara mbi konvencionet dhe treguesit gramatikorë.

i) **proformat**:

- përemrat vetorë;
- folja *bëj*;
- përemrat *i tillë, i atillë, i këtillë*;
- ndajfoljet *kështu, ashtu*;

ii) **kohezioni flektiv** – i bazuar mbi lidhjen e përshtatjes:

- mbaresat vetore;
- treguesit kundrinorë;

iii) **kohezioni leksikor**

- **sinonimie**;
- antonimet;
- hiponimet;
- hiperonimet;
- meronimet;
- fjalët bashkëvuajtëse: *zjarr – tym; vjeshtë – zverdhje e gjetheve* etj.

2. kohezioni pragmatik

a) përsëritja

- i) e njësisë leksikore;
- ii) e modelit ndërtimor të thënies;

b) parafraza;

c) perifraza;

d) elipsa.

Një vend të veçantë do t'i caktojmë **lidhëzimit**, i cili prej shumë autorëve përfshihet në kohezionin gramatikor. Lidhjet gramatikore të përbërësve në njësi më të mëdha realizohen përmes përshtatjes, bashkimit dhe drejtimit. Në rastin e lidhëzimit ne kemi bashkim të një thënie me një thënie tjetër, ku thënia që pason shton, mohon, pohon diçka në lidhje me atë që është parashtruar në thënien e parë. Lidhëzimi nuk është lidhje me përshtatje, drejtim ose bashkim. Por nuk është as lidhje e ngjashme me lidhjen e sifjalive brenda fjalisë së përbërë. Kjo vërehet në faktin se si lidhëzorë dalin njësi që u përkasin pjesëve të ndryshme të ligjëratës, jo vetëm lidhëzat. Gjithashtu edhe lloji i lidhjeve midis thënieve është i ndryshëm nga lloji i lidhjeve midis sifjalive. Lidhëzat në fjalinë e përbërë janë një mjet gramatikor, pa të cilin nuk arrihet ndërtimi i strukturës gramatikore. Në rastin e lidhëzorëve, teksti qëndron edhe pa praninë e tyre. Por raportet logjiko-semantike mes thënieve ndryshojnë. Pra ndryshon koherenca e tekstit. Në shembullin e mëposhtëm

(2) a. “Ai prandaj vinte këtu në tavernë. Prandaj edhe pinte. I dukej sikur këtu takohej me Ajkunën.” (Xhaferi, vepra 3, 2010:146).

b. “Ai vinte këtu në tavernë. Edhe pinte. I dukej sikur këtu takohej me Ajkunën.”

Lidhëzori *prandaj* vendos një raport shkak-pasojë midis thënies së tretë dhe dy thënieve të para në (2a). Thënia e tretë është shkaku i veprimeve të shprehura prej dy të parave. Nëse e heqim lidhëzorian *prandaj* (2b), vërejmë që organizimi i thënieve pa të i jep tekstit karakterin e një teksti informativ, ku veprimet pasojnë njëri-tjetrit, pa lidhje varësie midis tyre. Edhe pinte do të thotë “ndonjëherë pinte, por jo rregullisht”, ndërkohë që *Prandaj edhe pinte* do të thotë “pinte rregullisht”. Prania, ose mosprania e lidhëzorëve e ndryshon brendinë e tekstit, raportet mes koncepteve dhe ndodhive që janë pjesë e botës së tekstit. Midis dy fjalive që lidhen përmes një lidhëzori përkatës vendoset një lidhje logjiko-semantike.

Si rast të kohezionit pragmatik kemi trajtuar edhe elipsën, pasi në rastin e saj elementi gjuhësor as përsëritet e as zëvendësohet. Ai lihet jashtë. Mund të themi se elementi rimerret përmes mungesës së tij. Elipsa është një operacion thënësor, pasi një element i domosdoshëm i strukturës së fjalisë, argument i foljes, apo edhe vetë folja, nuk realizohet fonologjikisht, por është i pranishëm në aktin kumtues, pasi është i rrokshëm si për dhënësin ashtu edhe për marrësin.

BIBLIOGRAFI

- Brinker, K. (1985, 1992), *Linguistische Textanalyse*. Berlin: E. Schmidt. (= Grundlagen der Germanistik, 29).
- De Beaugrande, R.-A. & Dressler, W. U. (1981), *Einführung in die Textlinguistik*. Tübingen: Niemeyer. (=Konzepte der Sprach- und Literaturwissenschaft; 28).
- Dibra, K. & Varfi, N. (1999), *Gjuhësi teksti*. SHBLU, Tiranë.
- Halliday, M. K.A. & Hasan, R. (1976), *Cohesion in english*. London: Longman.
- Përnaska, R. (2015), *Gjuhësi... ..gjuhësore*. MALUKA. Tiranë.
- Rugova, B. & Rugova-Sejdiu, L. (2015), *Hyrje në gramatikën e tekstit të gjuhës shqipe*. Trembelat: Prishtinë.
- Schwarz-Friesel, M. & Consten, M. (2014), *Einführung in die Textlinguistik*. WBG (Wiissenschaftliche Buchgesellschaft), Darmstadt.
- Topalli, T. (2011), *Gjuhësi teksti*. Shkodër.
- Vater, H. (1992, 2001), *Einführung in die Textlinguistik*. (3. Auflage). Wilhwlrm Fink Verlag: München.

